

## KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE TE PERBASHKET SHQIPTARE

" AGJENSIA DOGANORE- ERAINI - SH.P.K "

E lidhur ndermjet paleve:

- 1- Alketa Liko, e bija e Lilit, lindur me 1971 ne Iushnje dhe banues ne Tirane ne Rr. Maliq Muço, pallati 46/2/I0
- 2- Kreshnik Cela, i biri i Naimit, lindur me 1962 ne Rrogozhine, banues ne Rr Sitki Cico, Pallati 3/I Tirane.

Te dy palet duke qene teek prenimeshem, te deklaruar ortake rane dakort qe kontraten e themelimit te shoqerise te perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjit Nr. 7638 dt 19.II.1992 " Per shoqerite tregetare qe vendosen sa me poshte:

### NENI 1

Te krijojne shoqerine e perbashket tregetare, shqiptare me Pergjegje si te Kufizuar( SH.P.K) e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe Ligji 7638 dt 19.II.1992" Per shoqerite tregetare"

Kjo shoqeri do te emertohet" AGJENSIA DOGANORE ERAINI - SH.P.K " me emertim te shkurtuar" ADE- SH.P.K"

### NENI 2

Shoqeria e perbashket " ADE - SH.P.K " do ta kete qendren ne qytetin e Tiranes ne Rr" Maliq Muço" Pallati 46/2/I0 dhe do te ushtroje veprimtarin per nje periudhe kohe mbi 10 vjet me te drejte perseritje per periudhea te metejshme neqofte se bien dakort ortaket unanimisht ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 3

Shoqeria " ADE- SH.K.P" do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

- Veprimitari te Agjensise se ndermjetesimeve doganore, me sherbimet perkatese, maganizime doganore, sigurim furnizime te ndryshme per mjete te transporteve te ndryshme e te udhetareve, dhe njesi te shitjes se lire.
- Operacione tregetare komisionerie
- Zyre per kembimin e valutave.
- Transaksione te ndryshme ne import eksportin e çdo malli qe shkarkohet ne Republiken e Shqipërisë

ne Republiken e Shqiperise, prek kufirin e saj shteteror ose nuk e prek fare ate.

- Veprimitari tregetare te artikujve te ndryshem industriale e ushqimeve, me shumice e pakice importe dhe eksporte.

- Veprimitari turistike, hoteleri e restorante si dhe çdo aktivitet qe veças ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per rrjetjen e zhvillimine e Shoqerise" ADE- SH.P.K

Shoqeria mund te mari pjese e te bashkepunoje me shoqeri te tjera qe kane veprimitari te njejte ose qe lidhet drejt perdrejt ose indirekt me te

NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje epertimin, vendqendrimin dhe objektin e veprimitarise se saj sipas vendimeve qe do te marrin me miraatin te perbashket, dy ortaket.

NENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaket rane dakort te bashkojne kapitalet e tyre, per personjen e organizimit e zhvillimin e veprimitarise se saj.

Kapitali i Shoqerise" ADE- SH.P.K " do te jete 100000 leke dhe perbehet nga kontributet e derdhura si me poshte:

I- Z. Alketa Liko kontribuon me 50000 leke ose 50% te kapitalit

2- Z. Kreshnik Cela kontribuon me 50000 leke ose 50% te kapitalit

Zj. Alketa Liko mer 50 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numuri i serise nga I- 50

Z. Kreshnik Cela mer 50 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri i serise nga Nr I deri 50

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer ~~përvejet~~ isht pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket, por ne asnjë rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortakuun tjeter te rrise kuaten e tij ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysme e kapitalit themelor, ortake

vendosin brenda tme muajve nga miratimi i llogarive te percaktojne kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj ma nje vlore jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar nga fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku qe ka nder mend tu shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht, duhet te njoftoje me pare ortakun tjeter te shoqerise i cili ka te drejten e parablerjes, qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja
- Administratori

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise

NENI 9

Asambleja drejtohet nga Presidenti i shoqerise. Ortaket themelues te shoqerise kane zgjedhur si President te saj zj. Alketa Liko, ndersa si administrator i shoqerise zotin Kreshnik Cela.

NENI 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese Jane miratuar nga te dy ortaket e saj. Vendimet e Asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim, nese nje nga ortaket nuk ka kerkuar mbledhjen e Asamblese.

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja ku shoqeria ka llogarite esaj rrjedhese.

Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i secilit ortak. Po keshtun shoqeria ka dhe perdon dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabiliteten e gjithe kerkesave te tjea financiare, te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise,

mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet e ndryshme dhe te jetë hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

NENI 13

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimi e organeve kompetente sipas legjislatacionij ne fuqi.

NENI 14

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit te eksperencies se shkembyer te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

NENI 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqiptare ne perputhje me legjislatacionin ne fuqi.

NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleja percakton menyren e likuidimit dhe emeron nje ose me shume shlyeres sipas normave ligjore.

NENI 17


Kjo kontrate u perpilua ne prani te dy ortakeve duke shprehur ne te vull -netin e lire te tyre.

Kontrata u perpilua ne tri kopje me fuqi te barabate secila, per tu depozituar ne organet gjyqesore dhe tatimore Tirane si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGETARE

"AGJENSIA DOGANORE ERAINI"

ALKETA LIKO



KRESHNIK CELA

